

TIRANE 2020

**RREGULLORE PER MARRJEN E
MASAVE PER PARANDALIMIN
E PERHAPJES SE COVID 19
NE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**



**UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANES**

Sheshi "Nënë Tereza",4
Tiranë ALBANIA
Tel: +355 4 2227914
Web: upt.al

RREGULLORE

“PËR

PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID – 19 GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”

Universiteti Politeknik i Tiranës, në vijim të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID – 19, me qëllim vijimin e veprimtarisë akademike dhe administrative në kushtet e sigurisë shëndetësore të lartë për studentët, personelin akademik dhe administrativ të institucionit, si dhe me qëllim zbatimin e një plani masash organizative dhe administrative për parandalimin e përhapjes së virusit COVID – 19 në ambientet e tij, vendosi të miratojë këtë rregullore:

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe praktikave të duhura për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID – 19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- Të sigurojë reduktimin e transmetimit të infeksionit midis studentëve dhe personelit të Universitetit Politeknik të Tiranës;
- Të sigurojë një ambient të shëndetshëm në punë;
- Të sigurojë vijimin normal të veprimtarisë së institucionit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. UPT – është Universiteti Politeknik i Tiranës;
2. Personel – është tërësia e punonjësve akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të punësuar në UPT.
3. Studentë – Çdo person i regjistruar në një program studimi të ciklit të I, II apo të III në UPT.

4. Personat përgjegjës – janë punonjësit e ngarkuar me urdhër të përbashkët të rektorit dhe administratorit të UPT – së për të siguruar zbatimin e masave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 4

Kujdesi për higjenën

1. Në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjenës ku përfshihet sapun i duarve, dezinfektant me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, kosha të mbyllur për eliminimin e mbetjeve, produkte pastrimi për dezinfektimin e ambienteve të institucionit si dhe ujë i rrjedhshëm.
2. Personeli dhe studentët e UPT – së, gjatë qëndrimit në institucion, duhet të mbajnë detyrimisht mjete mbrojtëse personale: si maska të cilat shërbejnë si barrierë fizike për minimizimin/kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID – 19.
3. Personeli dhe studentët të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizikë dhe higjena personale brenda dhe jashtë institucionit, nëpërmjet mesazheve sensibilizuese.
4. Studentëve duhet ti komunikohet në mënyrë të vazhdueshme për rregullat e higjenës, larjen e duarve, tështitjes dhe kollitjes.
5. Personeli dhe studentët duhet të lajnë duart pas çdo veprimi që mund të përbëj rrezik për përhapjen e virusit si: prek hundën, sytë, gojën etj.
6. Dritaret e ambienteve (salla, auditore, laboratore dhe zyra), duhet të mbahen të hapur e të ajrosen 5 - 6 herë në ditë.
7. Sallat dhe zyrat duhet të kenë aq student dhe personel sa të sigurohet distancimi 1.5 deri në 2 metra nga njeri tjetri.
8. Në një sallë apo zyrë të mos qëndrojnë më shumë student apo personel sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis duke respektuar distancimin social dhe fizik,
9. Aktivitetet jashtëshkollore, sportive dhe artistike në grup janë të ndaluara.
10. Të afishohen në të gjitha ambientet e UPT – së postera mbi masat e parandalimit të COVID - 19 dhe postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta.
11. Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.
12. Në hyrje dhe dalje të ambienteve të UPT – së rekomndohet të vendoset një higjenizues për duart në formë solucioni me përmbajtje aktive alkooli 60 përqind i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm.
13. Në ambientet e UPT – së si zyra, auditore apo laboratore, duhet të praktikohet pastrimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe elementeve të tjera si tavolina, tastiera, telefona, parrakët dhe dorezat, nga punonjësit e pastrimit. Produktet dezinfektante që përdoren për pastrim, të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë. Në çdo rast përdorimi i tyre bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale.

Neni 5

Hyrja dhe dalja e studentëve në ambientet e UPT - së

1. Orari për hyrjen e studentëve në ambientet e a UPT – së rregullohet sipas grafikut të orarit mësimor të paracaktuar dhe nën mbikëqyrjen e pedagogëve dhe administratës.
2. Studentët paraqiten në ambientet e institucionit duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga Sekretaritetë Mësimore.
3. Studentët dhe personeli që kanë simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në ambientet e UPT – së, njoftojnë personin përgjegjës të caktuar i cili në bashkepunim me mjekun e familjes verifikon nëse personi është sëmurë apo jo.
4. Personat përgjegjës duhet të kryeje procedurën e mëposhtme për çdo student dhe punonjës:
 - a. Matje e temperaturës me termometër digjital;
 - b. Sprucim me alkool 60 ose dezinfektant në duar;
 - c. Kontrollin nëse studentet dhe punonjësit janë të pajisur me maskë ose mbrojtese për fytyrën prej tekstili si dhe shami letre për higjienen e duarve.
5. Nuk lejohet që studentët të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të brenda ditës.
6. Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje nga ndërtesa.
7. Hyrja dhe dalja në ambientet e UPT bëhet duke ruajtur distancimin fizik dhe social 1.5 deri në 2 metra nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës të institucionit

Neni 6

Lëvizjet në ambientet e brendshme të UPT – së

1. Lëvizja e personelit dhe studentëve në salla, auditore, laboratorë dhe korridore, duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë të tillë që çdo zonë të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të.
2. Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
3. Personeli dhe studentët duhet të mbajnë largësi nga 1.5 deri në 2 metra nga njëri tjetri kur lëvizin në ambientet e brendshme të UPT – së.
4. Komunikimi i studentëve me drejtuesit, sekretarinë mësimore apo personelin akademik, do të kryhet duke respektuar rregullat e distancimit fizik dhe mundësisht nëpërmjet telefonit apo kompjuterit kur studenti nuk ndodhet në sallë.

Neni 7

Qëndrimi dhe mësimi në auditore

1. Gjatë procesit mësimor, pedagogu qëndron në sallë duke respektuar distancimin social dhe fizik me studentët dhe pedagogët e tjerë 1.5 deri 2 metra.
2. Brenda auditorit studentët qëndrojnë ulur në banka të paktën 1.5 deri 2 metra larg njeri tjetrit. Në sallat ku kjo nuk është e mundur, studentët do ndahen në salla të tjera.
3. Pedagogët sigurohen që në salla të gjithë të jenë të pajisur me maska dhe ti mbajnë ato rregullisht.
4. Nuk lejohet ushqimi në salla.

Neni 8

Detyrimet e personave përgjegjës

1. Personat përgjegjës duhet të vendosin postera në të gjitha ambientet e UPT – së për të inkurajuar higjenën e duarve për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID – 19.
2. Personat përgjegjës duhet të:
 - a. Kryejnë matje të temperaturës me termometër digjital;
 - b. Sprucim me alkool 60 % ose dezinfektant në duar;
 - c. Kontrollin nëse studentet janë pajisur me maske ose mbrojtese për fytyrën prej tekstili si dhe shami letre për higjenën e duarve
3. Personat përgjegjës duhet të vendosin elementet e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemesë.
4. Rregullorja mbi masat e kufizimit të përhapjes së COVID – 19, duhet të publikohet në faqen zyrtare të UPT – së, si dhe në ambiente të dukshme të institucionit.
5. Personat përgjegjës duhet të kontrollojnë që hyrja dhe dalja në ambientet e UPT - së të behet duke ruajtur distancimin fizik dhe social 1.5 deri në 2 metra.
6. Personat përgjegjës, për aq sa është e mundur, duhet të përmirësojnë kontrollet inxhinierike, me qëllim rritjen e niveleve të ventilimit dhe të përqindjes së ajrit që qarkullon në sistem.

Neni 9

Detyrimet e personelit dhe studentëve

1. Personeli dhe studentët e UPT – së duhet të përdorin mjetet e mbrojtjes personale si maska.
2. Personeli dhe studentët duhet të lajnë duart ose të përdorin dezinfektant në rast se janë të ndotura apo pas heqjes së maskës dhe dorezave.
3. Personeli dhe studentët nuk duhet të përdorin shtrëngimin e duarve por metoda të tjera jo kontaktuese të përshëndetjes.
4. Personeli dhe studentët duhet të ruajnë distancimin social/fizik gjatë qëndrimit në ambientet e UPT – së prej së paku 1.5 deri në 2 (dy) metra.

5. Personeli dhe studentët duhet të respektojnë praktikën e etikës respiratore, kollitjes dhe tështitjes nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës.
6. Personeli dhe studentët janë të detyruar të deklarojnë pranë personave përgjegjëse nëse kanë patur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me COVID – 19. Në rast se personeli apo studentët kanë patur apo kanë kontakt të ngushtë me një person të infektuar me COVID – 19, duhet të qëndrojnë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturat përgjegjëse.
7. Përpara se të rifillojnë mësimin sipas kësaj rregulloreje, studentët duhet të plotësojnë formularin e vetdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID – 19.

Neni 10

Detyrimet e personelit sanitar

1. Personeli sanitar detyrohet të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solicione dezinfektuese.
2. Korridoret pastrohen çdo 2 orë.
3. Tualetet pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.
4. Dorezat e çdo salle dhe mjedisi pune si dhe parruket e shkallëve dhe vende të tjera, pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.
5. Largimi nga UPT bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
6. Personeli sanitar kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin fizik e social me studentët dhe pedagogët.

Neni 11

Detyrimet e rojes së institucionit

1. Roja duhet të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solicione dezinfektuese.
2. Roja nuk lejon prezencën e prindërve apo personave të tjera brenda ambienteve të institucionit (me përjashtim të studentëve dhe personelit).
3. Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin/administratën e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të përcaktuar paraprakisht.
4. Roja e institucionit kryen detyrat duke ruajtur distancimin social dhe fizik me studentët dhe pedagogët.

Neni 12

Drejtuesit e institucionit dhe njësisë kryesore

1. Ngrënë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standarteve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Monitorojnë pajisjen e personelit, studentëve me mjete mbrojtëse maskë, doreza, xhel dezinfektues sipas mundësive.
3. Mbajnë kontakte përmes komunikimit elektronik me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e shëndetit publik, policinë e shtetit dhe organe të tjera ligjzbatuese.
4. Për çdo student apo pedagog që paraqet probleme shëndetësore si rritje temperature apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID - 19, lajmëron Njesinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe strukturën përkatëse në keto njësi.

Neni 13

Masat disiplinore

Për personelin dhe studentët që nuk respektojnë këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Etikës.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Rektorati i UPT – së